

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Don Est Construction" Sh.p.k.**

Sot, më datë 03/02/2025,

- "Wealthy Bee" Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar me 26/02/2021, me NUIS M11426012T, me seli në: Rruga "Gjin Bue Shpata", Nr. pasurie 1/181/ND+N3, kat 2 (prane ish-urgjences), Tirane, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Erdi Sakej, mbajtes i mjetit te identifikimit me nr. personal K10727051D, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, " Për regjistrimin e biznesit ", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Don Est Construction" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "Don Est Construction" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Gjin Bue Shpata", Kati II-të, Nr.Pasurie 1/181/ND+N3, (pranë ish Urgjencës), Tirana.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Veprimtari ne fushen e Ndertimit;
- Zbatim dhe projektim, ndertime civile, ekonomike, industriale, turistike, bujqesore etj.
- Punime karperterie, rikonstruksione godinash civile e ekonomike, veshje fasadash, etj.
- Ndërmjetësim në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtegjyqesish.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike

shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (*nje milion*) Lekë dhe është i përbërë nga një kuote. Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- “Wealthy Bee” Sh.p.k, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 Lekë (*nje milion*) Lekë dhe 1.000.000 Lekë (*nje milion*) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statutit.

## NENI 6

### ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.  
*Z. Kledi Cani*, shtetas shqiptar, lindur me 26/01/1999, ne Shkoder, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal J90126081I madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7

### LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

### DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themeli hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Kledi Cani* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### ORTAKU THEMELUES

“Wealthy Bee” Sh.p.k

Perfaqesuar nga

Edri Sakej

*Edri Sakej*

